

Shënim metodologjik mbi inflacionin bazë

Çfarë është inflacioni bazë dhe përse shërben

Inflacioni bazë mat rritjen e çmimeve të artikujve me çmimet më të qëndrueshme në shportën e konsumit, duke përjashtuar ndikimet e artikujve me luhatje çmimesh më të larta dhe / ose të atyre artikujve, çmimet e të cilëve janë subjekt i goditjeve të përkohshme. Si i tillë, ai pasqyron më mirë trendin afatmesëm të inflacionit, trend i cili ndikohet nga faktorë makroekonomikë që janë subjekt i ndikimit të politikës monetare.

Ky tregues ndihmon bankat qendrore të kuptojnë më mirë presionet inflacioniste të qëndrueshme dhe të hartojnë politika monetare në funksion të garantimit të një inflacioni të ulët dhe të qëndrueshëm.

Matje të inflacionit bazë në Bankën e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë përdor disa matje të inflacionit bazë, për qëllim analize dhe vendimmarrjeje të politikës monetare. Për llogaritjen e tyre, të dhënat merren nga Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), i publikuar nga INSTAT me frekuencë mujore.

- **Inflacioni bazë** është një matje e cila përjashton në mënyrë të përhershme nga shporta e IÇK-së nëngrupet: fruta, perime, karburante, mallra të akcizës dhe mallra me çmime të rregulluara. Në këtë matje përfshihen disa ushqime të përpunuara, të cilat deri në fund të vitit 2021 kanë pasur çmime relativisht të qëndrueshme. Në vitin 2024, inflacioni bazë llogaritet mbi artikuj të cilët përbëjnë 69% të shportës së IÇK-së, ndërsa 31% e artikujve të tjerë janë të përjashtuar. Këto pesha mund të ndryshojnë çdo vit, për shkak të përditësimit të shportës, edhe nëse artikujt e përjashtuar mbeten të njëjtët.
- **Inflacioni bazë neto** është një matje e cila përjashton nga inflacioni bazë të gjitha ushqimet. Në vitin 2024, inflacioni bazë pa ushqime llogaritet mbi artikuj të cilët përbëjnë 46% të shportës së IÇK-së, ndërsa 54% e artikujve të tjerë janë përjashtuar. Këto pesha mund të ndryshojnë çdo vit, për shkak të përditësimit të shportës, edhe nëse artikujt e përjashtuar mbeten të njëjtët.
- **Inflacioni pa ushqime dhe mallra energjetike** është një matje e cila përjashton komponentët më të luhatshëm të çmimeve të ushqimeve dhe të mallrave energjetike. Ajo mat inflacionin e komponentëve më të qëndrueshëm, të cilët janë çmimet e shërbimeve dhe të mallrave industriale, dhe përdoret gjerësisht nga bankat qendrore, pasi ofron një tregues të thjeshtë dhe të qartë për presionet e qëndrueshme inflacioniste.
- **Inflacioni bazë sipas Mesatares së Reduktuar** është një matje e cila përjashton ndryshimet ekstreme të çmimeve nga llogaritja. Kjo matje përjashton 15% të artikujve në skajin më të ulët dhe 15% në skajin më të lartë të shpërndarjes së ndryshimeve mujore të çmimeve. Më pas, llogaritet një mesatare e rripeshuar e ndryshimit mujor të çmimeve për 70% të artikujve të mbetur që ndodhen në zonën qendrore të shpërndarjes. Artikujt e përjashtuar ndryshojnë çdo muaj, në varësi të luhatshmërisë së çmimeve për atë periudhë, duke e bërë këtë qasje më fleksibël se matjet e tjera.
- **Inflacioni bazë sipas Medianës së Peshuar** është një matje, e cila filtron sistematikisht luhatjet e mëdha të çmimeve. Në këtë matje, inflacioni bazë përcaktohet si inflacioni i asaj pjese të shportës së IÇK-së, të cilës i korrespondon 50% e peshës kumulative të shportës totale. Ajo është vlera e inflacionit ku gjysma e peshës së artikujve në shportë qëndron mbi të dhe gjysma tjetër qëndron nën të. Kjo metodë është e ngjashme me mesataren e reduktuar.